



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik
-KUVENDI I KOMUNËS -

01Nr. 08 -320-8651/2013
Kaçanik, 26.03.2013

Në bazë të nenit 12 lidhur me nenin 17 (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 40.2 lidhur me nenet 6.2 dhe 61.1 të Statutit të Komunës, Kuvendi i komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 26.03.2013, merr këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË
TË DREJTORISË SË BZHRP

I.

Me këtë Vendim, lejohen mjete buxhetore nga pozicioni i subvencione dhe transfereve në shumë: **45,000.00 €** për realizimin e projekteve të drejtorisë së bujqësisë, zhvillimit rural dhe Pylltarisë(DBZHRP).

II.

Me shumën e mjeteve të lejuara si në pikën I. të këtij vendimi, do të realizohen për projektet si në vijim:

1. Projekti për subvencionim të fermerëve me farë misri dhe pleh mineral, shuma e mjeteve **9800 €**,
2. Projekti propozimi me fidan të mollës, **shuma e mjeteve 12.550 €**,
3. Projekti propozimi për bletari, **shuma e mjeteve 5.000 €**
4. Projekti për subvencionim të fermerëve me farë gruri dhe pleh mineral, shuma e mjeteve **12.990 €**
5. Projekti për eliminimin e qeneve endacak, **2.190 €**,
6. Projekti për organizimin e panairit të gjedhit “Kaçaniku 2013” **shuma e mjeteve 2.470 €**.

III.

Obligohet Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë të bëjë implementimin e projekteve ,sipas Projekteve detaje të cilat gjenden në këtë drejtori.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga kuvendi i komunës.

V.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë , Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

VI.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i komunës, Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit dhe Arkiva.

Kryesuesi i kuvendit,
Xhelal Gashi